



Funded by
the European Union

CARE Deutschland e.V. Zyra në Kosovë në kuadër të Projektit Pjesëmarrja e të Rinjve të Kosovës – KYP
shpall:

Thirrje për Aplikime

Mbështetje për Aktivitetet Sipërmarrëse të të Rinjve Udhëzues për aplikantët për nën-grante

Data: 25 korrik 2022

Afati i Aplikimit: 25 gusht 2022 në ora 12:00

Kjo thirrje për aplikim ka për qëllim **mbështetjen financiare për Aktivitetet Sipërmarrëse të të Rinjve në pronësi të personave juridikë: njësi biznesi të regjistruara dhe/ose organizata joqeveritare (OJQ).**

Kjo thirrje për aplikim është shpallur për dhënien e fondeve në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e të Rinjve të Kosovës – KYP”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga CARE Deutschland e.V., Zyra në Kosovë në partneritet me organizatën lokale SHL-Kosova. CARE Deutschland e.V. i është dhënë një kontratë e grantit në kuadër të thirrjes për propozime: Komisioni Evropian (Lot 2 – Demokracia Pjesëmarrëse, Angazhimi i të Rinjve), që synon të ndihmojë të rinjtë e pafavorizuar, mobilizimin në vendimmarrje, vullnetarizmin dhe punësueshmërinë.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit KYP është të mbështesë të rinjtë me më pak mundësi, veçanërisht gratë e reja, nga zonat rurale dhe qytetet e vogla të Kosovës, në mënyrë që të krijohen perspektiva shtesë për rritjen e pjesëmarrjes së tyre sociale dhe ekonomike. Objektivat specifike të projektit janë: të rrisë pjesëmarrjen demokratike, angazhimin qytetar dhe përfshirjen sociale të të rinjve me më pak mundësi, të marginalizuar dhe/ose me aftësi të ndryshme, veçanërisht të grave. Projekti fokusohet në tre komponentë kryesorë:

- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve të pafavorizuar në vendimmarrje, në komunitetet lokale dhe në nivelin qendror.
- Rritja e angazhimit dhe punësimit të të rinjve të pafavorizuar, në veçanti të grave të reja, përmes zhvillimit të aftësive dhe përfshirjes në iniciativat vullnetare.
- Nxitja e dialogut demokratik mes të rinjve kosovarë, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe promovimit të barazisë gjinore, solidaritetit, marrëdhënieve ndërkulturore dhe kundër stereotipeve dhe dezinformimit.



Pozita e të rinjve në Kosovë përcaktohet nga mungesa e mundësive praktike për pjesëmarrjen e tyre sociale dhe ekonomike. Me 53% të popullsisë nën 25 vjeç¹ Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, që paraqet një presion të madh demografik dhe ekonomik mbi shoqërinë kosovare, pasi çdo vit një gjeneratë e të rinjve përfundon shkollimin dhe fillon të kërkojë punë. Të rinjtë e Kosovës 15-24 vjeç kanë një shkallë jashtëzakonisht të lartë të papunësisë prej 46,9 %. Papunësia e grave të reja (15-24) është edhe më e lartë sipas të njëjtave statistika, në 61%, që tregojnë për marginalizim dhe përjashtim të shumëfishtë. Projekti KYP synon të mbështesë aktivitete të ndryshme që çojnë në punësim më të lartë të të rinjve në zonat e synuara të projektit.

Nën-grante për Mbështetjen e Aktiviteteve Sipërmarrëse të të Rinjve

Ky komponent i skemës së Mbështetjes Financiare për Palët e Treta (MFPT) është projektuar posaçërisht për aktivitete sipërmarrëse që angazhojnë të rinjtë dhe synon të **mbështesë aktivitetet krijuese sipërmarrëse të të rinjve dhe/ose ide të ngjashme të biznesit që promovojnë inovacionin**. Aktivitetet sipërmarrëse të të rinjve janë të pranueshëm për MFPT **vetëm nëse janë në pronësi të personave juridikë të regjistruar zyrtarisht: biznese të regjistruara ose organizata joqeveritare - OJQ, që aplikojnë me një plan biznesi të realizueshëm, i cili demonstroi kreativitet, inovacion dhe pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të të rinjve.**

Pritet që aktivitetet sipërmarrëse të mbështetura nga kjo thirrje do të intensifikojnë angazhimin social dhe/ose ekonomik të të rinjve dhe do të rrisin ndjeshëm aftësitë e tyre menaxheriale.

Aktivitetet sipërmarrëse të dhënies së nën-granteve pritet të arrijnë rezultatet e mëposhtme:

- Krijimin e mundësive të drejtpërdrejta për punësimin e të rinjve;
- Ndërmarrjen e trajnimeve në punë për të rritur aftësitë menaxheriale të të rinjve të përfshirë;
- Sigurimin e qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së subjekteve të mbështetura (bizneset e regjistruara/OJQ-të).

Projekti do të mbështesë deri në 5 aktivitete sipërmarrëse nga biznese të regjistruara dhe/ose OJQ, me një shumë mesatare të grantit prej 8,000 euro.

1.2 Afati kohor

Procesi i përzgjedhjes do të zhvillohet në periudhën gusht - tetor 2022. Nënshkrimi i kontratës për përfituesit e përzgjedhur përfundimisht pritet në tetor 2022.

1.3 Mbulimi gjeografik

Grantet do të ofrohen për subjektet formale: OJQ-të/bizneset e udhëhequra nga të rinjtë të regjistruara dhe që operojnë në këto komuna: Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gjakovë, Pejë, Rahovec, Obiliq dhe Suharekë. Projekti KYP do të përpiqet të arrijë një shpërndarje proporcionale të nën-granteve për secilën komunë të synuar; megjithatë, shpërndarja e mbështetjes financiare do të ndikohet edhe nga cilësia e aplikimeve të pranuar.

1. KUALIFIKUESHMËRIA

¹ Raporti i Asistencës së BE-së për Kosovën

https://eeas.europa.eu/archives/delegations/kosovo/documents/press_corner/education_for_the_future_en.pdf



Aplikantët e kualifikuar

- Bizneset e regjistruara zyrtarisht të udhëhequra nga të rinjtë (18 - 29 vjeç) dhe/ose
- OJQ-të e regjistruara zyrtarisht që punojnë në fushat e avancimit të rolit të shoqërisë civile për drejtësinë sociale, pjesëmarrjen, të drejtat e njeriut, kulturën, mjedisin dhe mediat me të dhëna të demonstruara të projekteve të mëparshme me të rinjtë në komunitetet lokale dhe përvojë në bashkëpunim me institucionet lokale; që aplikojnë me një ide të biznesit duke angazhuar drejtpërdrejt të rinjtë.

Aplikantët e pakualifikuar

- Individët
- Subjektet joformale

2. LLOJET E AKTIVITETEVE SIPËRMARRËSE QË DO TË MBËSHTETEN

Thirrja do të mbështesë sipërmarrjet/startupet inovative, të cilat fokusohen në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Ofrimin i shërbimeve që promovojnë të rinjtë, mobilizimin dhe të drejtat e njeriut
- Teknologjitë digjitale
- Prodhimin kreativ (artet, veprat artizanale)
- Sipërmarrjen sociale të të rinjve
- Teknologjitë e qëndrueshme dhe të gjelbra
- Aktivitetet tregtare kulturore/artistike
- Aktivitetet mediatike me komponent komercial.

Përveç fizibilitetit dhe qëndrueshmërisë, të gjitha aktivitetet sipërmarrëse të mbështetura duhet të shpjegojnë pikat në vijim:

- Si do të krijojë punësim për të rinjtë projekti i propozuar
- Si do të kontribuojë projekti i propozuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të aplikantit

Çështjet ndërsektoriale

Integrimi gjinor si mjet drejt barazisë gjinore do të jetë çështje ndërsektoriale gjatë të gjitha ndërhyrjeve. Si rregull i përgjithshëm, të gjithë kandidatëve u kërkohet të planifikojnë ndërhyrjet e tyre në mënyrë të barabartë, duke qenë të vetëdijsëm për efektet e ndërhyrjes për burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat, dhe të shmangin kontributin në stereotipe të dëmshme. Projekti veçanërisht do të **nxisë pjesëmarrjen e grave të reja në aktivitetet sipërmarrëse** të parashikuara në kuadër të aplikacioneve.

3. PËRSHTATSHMËRIA E KOSTOVE

3.1 Kostot e përshtatshme

Kostot e pranueshme janë ato kosto që:



- Janë të shënuara në buxhetin e propozuar si kosto të identifikueshme dhe të verifikueshme;
- Planifikohen të realizohen gjatë zbatimit të grantit;
- Të nevojshme për zbatimin dhe arritjen e suksesshme të idesë së biznesit (si blerja e pajisjeve të reja, materialeve, zhvillimi i prototipit, softueri, licencat, pagat e justifikueshme dhe reale, shpenzimet e funksionimit të biznesit etj.);
- Të arsyeshme, të justifikuara dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, duke përfshirë llogaritjet e drejta dhe të bazuara në treg dhe efikasitetin e kostos. Llogaritja e kostove në aplikacion duhet të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë.

3.2 Kostot e papërshtatshme

- Borxhi dhe provizionet ose pagesat për humbjet;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH;
- Shlyerjet e kredisë dhe interesit;
- Tarifat e këmbimit valutor;
- Shpenzimet për amortizimin e pajisjeve;
- Blerja e tokës ose e pronës së paluajtshme;
- Blerja e automjetit ose gjeneratorit;
- Blerja e mallrave të dorës së dytë;
- Pagesa e shpenzimeve të mbuluara nga donatorë të tjerë;
- Kreditë për palët e treta;
- Kostot e shpenzimeve kapitale, të tilla si infrastruktura dhe toka.

3.3 Ndërhyrjet/aktivitetet e mëposhtme nuk do të mbështeten:

- Ndërhyrjet që lidhen drejtpërdrejt me partitë politike ose janë mbështetëse të tyre;
- Investimet kapitale;
- Grantet e përbëra tërësisht ose kryesisht nga punë përgatitore dhe/ose studime;
- Idetë dhe aktivitetet e biznesit ndërkufitar që do të zbatohen jashtë Kosovës;
- Aktivitetet e llojit të shërbimit si Asistenca Teknike;
- Fushatat promovuese;
- Ndërhyrjet të cilat i nënshtrohen varësisë dhe miratimit në shumë nivele, duke paraqitur kështu rrezik të lartë për arritjen e rezultateve;
- Nën-grante për palët e treta;
- Bursat; diskutime në tryezë të rrumbullakët ose ngjarje të tjera të ngjashme në ambiente; Studime kërkimore dhe fizibiliteti, Udhëtime studimore.

4. KUSHTET E CIKLIT TË GRANTIT

Me marrjen e aplikacioneve, projekti KYP do të përzgjedhë një numër më të gjerë kandidatësh, të cilët do të ftohen **të marrin pjesë në trajnimin e projektimit të planit të biznesit të organizuar nga projekti**. Është e detyrueshme që aplikantët e ftuar të ndjekin trajnimin e planit të biznesit **për të rregulluar idetë e tyre të biznesit në plane të biznesit të realizueshme të cilat më pas do të hyjnë në përzgjedhjen përfundimtare për financim**. Pjesëmarrja në trajnimin e planit të biznesit nuk është garanci për financim.



Me nënshkrimin e kontratës, ekipi i projektit do të monitorojë dhe vlerësojë nga afër propozimet e financuara, deri në përfundimin e kontratave të nën-granteve.

Madhësia dhe kohëzgjatja e granteve

Lloji i aktivitetit të nën-grantit	Shuma maksimale për përfituesin e nën-grantit	# i mbështetjes së parashikuar	Kohëzgjatja e zbatimit të skemës së granteve nga momenti i nënshkrimit të kontratës	Shuma totale e parashikuar për thirrjen
Aktivitetet sipërmarrëse të të rinjve	€8,000	Deri në 5 propozime (Biznes/OJQ)	8 - 10 muaj	40,000€

Bizneset/OJQ-të e përzgjedhura përfundimisht për MFPT/grante pritet të nënshkruajnë kontratën e dhënies në tetor 2022.

Projekti ka të drejtën të përzgjedhë njërin apo asnjërin nga aplikacionet e paraqitura, si dhe të kërkojë informacione shtesë nga aplikantët në rast se nevojiten ndonjë sqarim për procesin e përzgjedhjes.

5. PROCEDURAT E PARAQITJES SË APLIKIMIT

Aplikimet do të dorëzohen përmes Formularit të Aplikimit të zhvilluar nga projekti, në cilëndo nga gjuhët e mëposhtme: shqip, serbisht dhe anglisht. Aplikanti nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikim. **Aplikimi i plotë duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në emailin në vijim: care.kosovo@care.org jo më vonë se më 25 gusht 2022.** Të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin e aplikimit (Shtojca 1)
2. Formularin e buxhetit (Shtojca 2)
3. Dokumentin e regjistrimit të biznesit për aplikimin e biznesit, certifikatën e regjistrimit të OJQ-ve, të lëshuar nga Departamenti për OJQ-të; dhe Certifikatën e Numrit Fiskal/UNI.
4. Pasqyra e qarkullimit total vjetor nga ATK për bizneset ekzistuese dhe certifikata që vërteton se biznesi dhe/ose OJQ-ja nuk ka borxh ndaj ATK-së (jo më e vjetër se 3 muaj).

Kërkesë për sqarime/Informacione të mëtejshme: Aplikantët mund të dorëzojnë kërkesat e tyre për sqarime deri më **19 gusht 2022 në orën 16:00**, në emailin: care.kosovo@care.org.

Aplikimet e pakompletuara dhe/ose aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh. Informacionet e paraqitura nga aplikantët do të përdoren në mënyrë rigoroze për qëllimet e kësaj thirrjeje dhe nuk do të ndahen me persona apo institucione të tjera, përveç rasteve kur kërkohet nga ligji i Kosovës ose kërkohet nga donatorët. Me paraqitjen e aplikimit të tyre, aplikantët do të marrin konfirmim të pranimit me një numër aplikimi.



6. KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROPOZIMEVE

HAPI 1: KONTROLLI ADMINISTRATIV

Aplikimi do të refuzohet nëse shqyrtimi i aplikimit zbulon gabime administrative, si në vijim;

- Aplikimi nuk ka mbërritur në kohën e duhur;
- Pako e aplikimit nuk është kompletuar;
- Nuk janë ofruar dokumentet e nevojshme mbështetëse;
- Formulari i aplikimit nuk është i vulosur dhe i nënshkruar nga personi i autorizuar;

HAPI 2: VLERËSIMI I CILËSISË PËR PËRZGJEDHJEN E LISTËS SË NGUSHTË TË KANDIDATËVE

Cilësia e aplikacioneve do të vlerësohet duke përdorur kriteret e vlerësimit më poshtë.

Kriteri për përzgjedhjen e listës së ngushtë	Pikët	Maksimumi
Cilësia e idesë së propozuar të biznesit		
A krijon biznesi i propozuar punësim të ri për të rinjtë?		15
Sa konsistente është ideja e propozuar e biznesit me kushtet e Thirrjes?		20
A ka ideja e propozuar e biznesit një komponent social që synon adresimin e problemeve të rinisë?		15
A merret parasysh veçanërisht përfshirja e vajzave të reja?		5
Aftësitë menaxhuese - fizibiliteti		
A demonstroi aplikanti ekspertizën dhe kapacitetin përkatës për të punuar në aktivitetin e sugjeruar sipërmarrës?		20
Kostot		
Sa realist dhe efektiv është buxheti në raport me idenë e propozuar të biznesit?		10
A janë reflektuar siç duhet elementët e biznesit në buxhet?		15
Totali i pikëve		100

7. VLERËSIMI, PËRZGJEDHJA E LISTËS SË NGUSHTË SË APLIKIMEVE DHE HAPAT E MËTEJSHËM

Procesi i përzgjedhjes do të bëhet në dy faza: përzgjedhja e listës së ngushtë dhe përzgjedhja përfundimtare.

Përzgjedhja e listës së ngushtë: Vlerësimi i ideve të biznesit – aplikimeve dhe parapërzgjedhja e aplikantëve do të bëhet nga Komisioni për Përzgjedhjen e Projekteve. Përzgjedhja do të bazohet në qartësinë, cilësinë, fizibilitetin, kreativitetin dhe inovacionin e ideve të biznesit.

Rezultatet e procesit të para-përzgjedhjes do të njoftohen me email në adresat e postës së aplikantit. Të gjithë aplikantëve të refuzuar do t'u dërgohen komente kthyesë në mënyrë elektronike me e-mail jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së vendimeve përfundimtare në lidhje me aplikimet e përzgjedhura për listë të ngushtë. Aplikantët e pasuksesshëm mund të ankohen brenda dy ditëve pune nga dita kur është dërguar emaili i refuzimit.



Aplikantët e përzgjedhur paraprakisht do të ftohen të marrin pjesë në trajnime të detyrueshme të projektit në zhvillimin e planeve të biznesit, mbi të cilat do të kërkohen planet përfundimtare të biznesit dhe do të ndërmerret **përzgjedhja përfundimtare** e përfituesve.

8. REALIZIMI I SKEMËS SË GRANTIT

a. Kontraktimi dhe pronësia

CARE Deutschland e.V., Zyra në Kosovë do të nënshkruajë kontrata me përfituesit përfundimtarë të granteve, duke rregulluar marrëdhëniet, pronësinë e tyre etj.

Dhënia e projektit do të realizohet nëpërmjet transaksionit të fondeve, me këste, nga CARE për përfituesit e përzgjedhur të granteve. Të gjitha pagesat për aktivitetet e miratuara sipërmarrëse do të bëhen më pas nga përfituesit e përzgjedhur, në mënyrë rigoroze, sipas shpenzimeve të miratuara nga planet e tyre të biznesit.

CARE Deutschland e.V., Zyra në Kosovë më pas do të ketë pronësinë mbi pajisjet dhe materialet e blera deri në fund të projektit KYP, kur të bëhet pronë e përfituesve.

Projekti KYP do të monitorojë përdorimin e fondeve të grantit gjatë gjithë procesit, përmes rishikimit të raportimit të rregullt, komunikimit të rregullt me përfituesit e grantit dhe vizitave periodike në terren. Përveç raportimit të rregullt në CARE, përfituesit e grantit (bizneset/OJQ-të) janë të detyruar t'i sigurojnë stafit të CARE qasje të pakufizuar në mallrat e blera, informacione mbi përdorimin e tij, si dhe mbi statusin e aktivitetit të tyre sipërmarrës (p.sh. regjistrimi, etj.), statusin e të rinjve të angazhuar dhe rezultatet e arritura ekonomike.

b. Kërkesa për përdorimin e pajisieve dhe dukshmërinë

Përfituesit e grantit janë të detyruar të përdorin grantin e projektit vetëm për qëllimin e aktivitetit të tyre sipërmarrës siç përshkruhet në planet e tyre të aprovuara të biznesit. Për të monitoruar shpenzimet, granti do të jepet me këste të lidhura me piketat kryesore. Në rast të keqpërdorimit të dëshmuar të fondeve, përfituesve do t'u kërkohet të kompensojnë dëmin dhe të paguajnë shumën e grantit për CARE.

Pajisjet e dhëna duhet të shënohen sipas kërkesave të dukshmërisë, të cilat do të sigurohen nga CARE.

c. Publiciteti

Përfituesit duhet të njohin kontributin e CARE Deutschland e.V., Zyra në Kosovë dhe fondet e Bashkimit Evropian (BE) në të gjitha publikimet, materialet audio-vizuale, praninë online dhe mediat sociale, ose aktivitete të tjera që promovojnë aktivitetin sipërmarrës të zhvilluar përmes grantit të projektit. Në këtë drejtim, logot e CARE dhe Bashkimit Evropian (BE) si dhe deklarata e mospranimit të përgjegjësive që do të përdoret, do t'u sigurohen aplikantëve të suksesshëm nga ekipi i projektit CARE.

9. AFATI KOHOR I PARASHIKUAR PËR PROCESIN E DHËNIES

Aktiviteti	Data
Thirrje për idetë e biznesit të lëshuara	25 korrik 2022
Kërkesat për Sqarim/Informacione (përmes emailit)	19 gusht 2022
Sesioni Informues (online)	5 gusht 2022 (nga 11:00 - 12:00) (Bashkohuni në takimin në Zoom) https://careorg.zoom.us/j/95933485885?pwd=S3lpOG1RYXhnT0xDWE9VeFJiNE5RQT09



Funded by
the European Union

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve	25 gusht 2022 deri në ora 12:00
Përzgjedhja e listës së ngushtë të aplikantëve. Ftesa për të marrë pjesë në trajnime për hartimin e planeve të biznesit	8 dhe 9 shtator 2022
Trajnim 3-ditor mbi Zhvillimin e Planit të Biznesit (dy raunde)	12 - 19 shtator 2022
Dorëzimi i buxhetit dhe planeve të finalizuara të biznesit	26 shtator 2022
Njoftimi i pritshëm për dhënien e grantit	3 - 4 tetor 2022
Nënshkrimi i kontratës	10 - 11 tetor 2022